


Zgjedhjet Parlamentare 2020 – Analizë e listave për kandidatë Përmes objektivit të përfshirjes sociale dhe politike



Shkup 2020

Përmbajtja

Lista e shkurtesave	5
Hyrje	6
Kushtet ligjore për listat për kandidatë për zgjedhjet parlamentare	7
Përfshirja sociale dhe politike	9
Metodologjia dhe kufizimet	10
Pasqyra e përgjithshme e listave për kandidatë	12
Përfaqësimi gjinor	12
Përfaqësimi etnik	14
Përfaqësimi i personave të rinj (18-29 vjet)	17
Përfaqësimi rural – Kandidatët nga komunat rurale	18
Gjetjet dhe përfundimet	20
Aneksi 1- Përfaqësimi gjinor	21
Aneksi 2- Gratë si bartëse të listave për kandidat për parti të politike dhe njësitë zgjedhore.....	22
Aneksi 3- Përfaqësimi etnik.....	23
Aneksi4- Përfaqësimi i kandidatëve të rinj (18-29 vjet).....	24
Tabela 1: Shpërndarja e listave për kandidat dhe votuesve për njësinë zgjedhore.....	12
Tabela 2: Përfaqësimi gjinor në listën për kandidat për njësinë zgjedhore.....	13
Tabela 3:Numri i grave si bartëse të listave zgjedhore në njësitë zgjedhore	14
Tabela 4:Numri i listave shumë-etnike për kandidat në njësitë zgjedhore	15
Tabela 5:Numri i kandidatëve me përkatësi të ndryshme etnike për njësitë zgjedhore.....	16
Tabela 6:Numri i kandidatëve të rinj dhe përqindja e gjinisë femërore në kuadër të kandidatëve të rinj...	17
Tabela 7: Kandidatët e rinj në 5 pozitat më të larta të listave për kandidat	18
Tabela 8: Numri i kandidatëve që jetojnë në komunat urbane dhe rurale	19

Lista e shkurtesave

ASH	Aleanca për Shqiptarët
BDQ	Bashkimi Demokratik Qytetar
KiE	Këshilli i Europës
PDSH	Partia Demokratike e Shqiptarëve
BDI	Bashkimi Democratik për Integrim
KZ	Kodi Zgjedhor
NjZ	Njësia Zgjedhore
BE	Bashkimi European
ORRM- PP	Opsioni Ripërtirës Reformues Maqedonas – Partia e punëtorëve
ODIHR	Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë
KSHZ	Komisioni Shtetëror Zgjedhor
LDSM	Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë
BSD	Bashkimi Social Demokrat Shkup
OBRM-PDUKM	Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demkkratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë

Hyrje

Zhvillimet politike – Pas një mosmarrëveshje të disa dekadave me Greqinë, në janar të vitit 2019 shteti e ndërroi emrin e tij në Republika e Maqedonisë së Veriut. Kjo ka hapur rrugën në integrimin Euro-Atlantik dhe në shkurt të vitit 2020, Parlamenti (Kuvendi) miratoi Traktatin e Atlantikut të Veriut. Në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE, kishte pritshmëri që shteti të ftohet të fillojë negociatat e anëtarësimit si rezultat i takimit të Këshillit European në tetor të vitit 2019. Kjo nuk ndodhi dhe është marrë një vendim për zgjedhje të parakohshme parlamentare që do të mbahen në 12 prill, 2020.

Sa i përket kushteve ligjore që të emërohet një qeveri teknike të paktën 100 ditë përpara zgjedhjeve, parlamenti, e zgjodhi qeverinë teknike në 3 janar të vitit 2020 dhe në 16 shkurt, 2020, pas ndryshimit të Kodit Zgjedhor, është shpërbërë parlamenti. Komisioni Shtetëror Zgjedhor (KSHZ) filloi procesin e përgatitjes të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare dhe kalendari për zgjedhjet duhej të përfundohej brenda periudhës 60 ditore.

Pandemia e virusit Korona – rastet e para të personave të infektuar në shtet me COVID-19 janë regjistruar në fillim të Marsit dhe kjo është ndjekur nga prezantimi i masave parandaluese. Meqënëse aktivitetet zgjedhore tashmë kishin filluar, disa prej tyre ishin ndalur siç janë trajnimi i anëtarëve të Komisionit Komunal Zgjedhor dhe anëtarët e Këshillave Zgjedhore dhe mbyllja e listës zgjedhore. Me ngritjen e numrit të personave të infektuar, Presidenti i shtetit deklaroi gjendjen e jashtëzakonshme në shtet, kurse mandati i qeverisë teknike është zgjatur.

Procesi zgjedhor – nën këto rethana, qeveria teknike ka pushtetin ekzekutiv dhe atë legjislativ. Dekreti i qeverisë¹ ka zgjatur mandatin e KSHZ për gjashtë muaj pasi të jenë mbajtur zgjedhjet parlamentare, përderisa të gjithë aktivitetet zgjedhore janë ndalur. Kur do të hiqet gjendja e jashtëzakonshme, KSHZ duhet të përgatisë një kalendar të rishqyrtuar për aktivitetet zgjedhore, që të mund të vazhdojë procesi zgjedhor.

Gjatë kohës që po shkruhet kjo analizë e cila është në suaza të projektit “Mbështetja e reformave zgjedhore në Maqedoninë e Veriut”, Presidenti Pendarovski ka zgjatur gjendjen e jashtëzakonshme deri në 16 mars, 2020, kur kushtet do të vlerësohen sërish për të vendosur nëse masat e jashtëzakonshme do të hiqen apo vazhdohen. Në rast se vazhdohen, KSHZ duhet të përgatisë një kalendar të ri për zgjedhjet në bazë të së cilit duhet të vazhdojë procesi zgjedhor. Masat parandaluese dhe konsideratat për shëndetin e administratës zgjedhore, pjesëmarrësve në zgjedhje, shoqërisë civile apo votuesve në përgjithësi duhet të integrohen me kujdes në procesin zgjedhor.

¹ https://drive.google.com/file/d/1iTMIPVvItYTXf0qZdlFrcbTIJD_DdGqM/view

Kushtet ligjore për listat e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare

Në demokracitë bashkëkohore, funksioni i brendshëm i partive politike përcaktohet nga dy parime: 1) parimi i autonomisë të partisë, ku partitë politike kanë autonomi shoqërore në funksionimin e brendshëm dhe të jashtëm. Sipas këtij parimi, partitë politike duhet të jenë të lira në vendosjen e organizimit dhe rregullave të tyre të brendshme për zgjedhjen e liderëve të partisë dhe kandidatëve, meqënëse kjo shihet si pjesë integruese e konceptit të autonomisë shoqërore; 2) parimi i demokracisë të brendshme, sespe partitë politike janë thelbësore për pjesëmarrjen politike, dhe rrjedhimisht duhet të respektojnë kushtet demokratike në kuadër të organizatave të tyre të brendshme.

Në pajtim me këtë që u tha më sipër, Udhëzimet e Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës (KiE) mbi Rregullat e Partive Politike theksojnë se: “Partitë duhet të kenë aftësinë për të caktuar zyrtarët dhe kandidatët partikë, të lirë nga ndërhyrja qeveritare. Duke njohur se përzgjedhja e kandidatëve dhe përcaktimit i radhitjes në listat zgjedhore shpesh dominohen nga entitetet e mbyllura dhe rrjetet e vjetra të politikanëve që janë për një kohë të gjatë, nevojiteshin kriteret e qarta dhe transparente për përzgjedhjen e kandidatëve, me qëllim që anëtarët e rinj (duke përfshirë gratë, dhe pakicat) të kenë qasje në pozitat e marrjes të vendimeve. Gjithashtu duhet të rekomandohet përbërja e balancuar gjinore në përzgjedhjen e organeve”²

Analiza e kornizës ligjore që rregullon punën e partive në Maqedoninë e Veriut³ tregon se ligjet dhe rregullat përshkruajnë procesin e regjistrimit, financimit, emrin dhe shenjat por nuk ndikojnë në përzgjedhjen e kandidatëve. Kjo është e rregulluar me Kodin Zgjedhor dhe me rregullat e brendshme të partive politike për emërimin e kandidatëve. Prosesi i përshkruar më poshtë është i zbatueshëm për zgjedhjet e rregullta parlamentare, kurse në rastet e zgjedhjeve të parakohshme, afatet janë të shkurtuara për 5 ditë.

Sipas Kodit Zgjedhor (KZ, lista e kandidatëve mund të parashtrohet nga përfaqësuesit e autorizuar të partive politike të regjistruara, koalicioneve dhe grupës të votuesve. Përderisa partitë politike të regjistruara dhe koalicionet mund të parashtrojnë lista për kandidat për KSHZ, grupi i votuesve (neni 61 i KZ) duhet së pari të grumbullojë të paktën 1,000 nënshkrime të votuesve të regjistruar në Listën Zgjedhore të njësisë përkatëse zgjedhore. Pasi të jenë grumbulluar nënshkrimet, grupi i votuesve mund të parashtrojë listen për kandidat për njësinë përkatëse zgjedhore.

Procedura për grumbullimin e nënshkrimeve nga grupi i votuesve për nominimin e kandidatëve është rregulluar me nenin 63 të KZ. Duke ndjekur ndryshimet e bëra në KZ në shkurt të vitit 2020, kandidatët (të nominuar nga grupi i votuesve) mund të grumbullojnë nënshkrimet në zyrat

2 CDL-AD(2010)024, para 113.

3 Ligji mbi partitë politike http://aa.mk/WBStorage/Files/Zakon_politicki_partii.pdf dhe Ligji mbi financimin e partive politike http://aa.mk/WBStorage/Files/Zakon_finansiranje_politicki_partii.pdf

rajonale të KSHZ dhe te noterët publike, që është si përgjigje respektivisht reagim për rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR të përfshirjes të alternativave për grumbullimin e nënshkrimeve, krahas në zyrat rajonale të KSHZ. Grumbullimi i nënshkrimeve zgjat 15 ditë dhe një votues mund të nënshkruhet për më shumë se një kandidat.

Listat e parashtruara të kandidatëve për deputetë duhet të përmbajnë këto elemente: numrin e njësisë zgjedhore, emrin e listës, emrin dhe simbolin (nëse dorëzuesi e ka një të tillë), emrin dhe mbiemrin e bartësit të listës, emrin dhe mbiemrin e secilit kandidat për deputetë dhe përmban aq kandidatë sa zgjidhen në njësinë zgjedhore, me shënimin e vendbanimit të tyre të përhershëm dhe numrit unik amë të qytetarit dhe deklaratë për përkatësinë e bashkësisë të caktuar (neni 64 I KZ).

Të paktën 40% e kandidatëve në listë duhet t'i takojnë gjinisë më pak të përfaqësuar, dhe është shënuar në KZ si në vijim: në çdo tre vende të listës, së paku një i takon gjinisë më pak të përfaqësuar, me të paktën një vend shtesë në ato 10 vende.

Pasi të jenë parashtruar listat, KSHZ siguron se janë dhënë të gjithë elementet e kërkuara dhe vërteton të dhënat e kandidatëve me institucionet përkatëse. Pasi të jenë konfirmuar, listat shpallet në gazetën ditore dhe një prej tyre duhet të jetë një gjuhën e komunitetit që e flasin të paktën 20% e qytetarëve në shtet. Shpallja e listave nga KSHZ nuk duhet të jetë më vonë se 23 para ditës së votimit (në rast të zgjedhjeve të parakohshme, afatet shkurtohen). Procesi i parashtrimit të listave të kandidatëve deri në shpalljen e tyre zgjat jo më shumë se 10 ditë. Procesi është përshkruar në neni 67 të KZ kurse në grafikonin më poshtë janë prezantuar vetëm hapat kryesorë.




Figura 1: Procesi i parashtrimit të listës të kandidatëve gjatë zgjedhjeve parlamentare

Siç është theksuar nga Komisioni i Venedikut të KiE, Kodi Zgjedhor është i heshtur në lidhje me tërheqjen e kandidatëve dhe listave të kandidatëve pasi ata të jenë vërtetuar nga administrata

zgjedhore. Kjo çështje mund të përfitojë nga rregullat e ardhshme, me qëllim të sigurimit të qartësisë ligjore. Kjo është edhe më e rëndësishme nën rethanat aktuale, kur procesi zgjedhor është në pritje dhe do të vazhdohet pas disa javësh/muajsh.

Përfshirja Sociale dhe Politike

Duke patur parasysh kornizën ligjore, çështja e përfaqësimit u mbetet parimeve demokratike të brendshme të partive politike kur zgjedhin kandidatët për zgjedhjet parlamentare, ky kapitull ofron një arsytim të mëtutjeshëm se pse listat e kandidatëve duhet të përpiqen të sigurojnë përfaqësim të atyre që janë të marginalizuar, të rrezikuar dhe më pak të përfaqësuar.

Përfshirja sociale është një koncept gjithpërfshirës dhe kompleks i përkufizuar si “procesi i përmirësimit të kushteve të pjesëmarrësve në shoqëri, sidomos për njerëzit që nuk janë në pozitë të volitshme, përmes rritjes të mundësive, qasjes në burime, në të shprehur dhe në respektimin e të drejtave”⁴.

Ka edhe shumë përkufizime tjera përveç asaj që është përmendur më lartë (Komisioni Europian 2004; Banka Botërore 2013; OBSH 2008) dhe të gjitha këto përshkruajnë paradigmen e shoqërisë përfshirëse përmes konceptit të: solidaritetit, integritit, kohezionit, kapitalit social dhe të ngjajshme.

Maqedonia e Veriut si një shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara është përkushtuar për zbatimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm si një thirrje univerzale për veprim për të përfunduar varfërinë, për të mbrojtur planetin dhe për të siguruar se të gjithë njerëzit gëzojnë paqe dhe prosperitet deri në vitin 2030⁵. Përfshirja sociale është mishëruar në përkufizimin e objektivave të ndryshëm duke përfshirë Objektivin 10 për “fuqizimin dhe promovimin e përfshirjes sociale, ekonomike dhe politike të të gjithëve, pavarësisht statusit të moshës, gjinisë, aftësisë të kufizuar, racës, etnisë, prejardhjes, religjionit, ekonomisë apo statusit tjetër”.

Përfshirja politike, si një pjesë integruese e përfshirjes sociale, nënkupton “angazhimin e të gjithëve në komunitet në procesin politik, siç është edukimi qytetar, votimi, kandidimi për pozitë, dhe ofrimi i kontributit për përfaqësuesit derisa po hartohen politikat dhe legjislacioni, duke kriuar një ndjenjë të agjencisë dhe përkatësisë”⁶. Duke e bërë një gjë të tillë, përfshirja politike përqëndrohet në grupet e rrezikuara në shoqëri si ata që janë me gjasa më të ulëta për të marrë pjesë dhe për të qënë të përfshirë.

4 <https://www.un.org/esa/socdev/rwss/2016/chapter1.pdf>

5 <https://www.mk.undp.org/content/north-macedonia/en/home/sustainable-development-goals/background.html>

6 https://www.gmfus.org/sites/default/files/achieving_political_inclusion.pdf

Besimi i njerëzve në parlament, dhe niveli i demokracisë në vend, është në lidhje të drejtëpërdrejtë me shkallën e pasqyruar të diversitetit të shoqërisë në institucionet siç është Parlamenti dhe proceset e lidhura me formulimin dhe operimin e tij. Fatkeqësisht, në shumë shtete, pjesë të mëdha të popullsisë janë përjashtuar nga politika duke u bazuar në moshën, gjininë, etninë, religjionin, aftësitë e kufizuara, apo faktorët tjerë të indentitetit.

Për shkak të kësaj që u përmend më sipër, kjo Analizë synon që të ekzaminojë **se deri në çfarë shkalle** dhe në cilin pozitë në listë, përfaqësuesit e grupeve të rrezikuara në shoqëri janë të përfshirë në listat për kandidatë si një tregues se sa përfshirëse dhe e dallueshme do të jetë përbërja e parlamentit të Maqedonisë së Veriut 2020-2023. Kjo mund të ndikojë në mënyrë të tërthortë nëse politikat dhe ligjet e miratuara nga Parlamenti do të jenë më të ndjeshme për, dhe do të reflektojnë për nevojat e të gjithë qytetarëve dhe gjithashtu do të promovojnë barazi më të madhe.

Duke patur parasysh se legjislacioni nacional nuk ofron përkufizim të përfshirjes sociale dhe se cilat janë grupet e marginalizuara dhe të rrezikuara në shoqëri, analiza fokusohet në grupet e mëdha vijuese që u referuan në trupin e literaturës të analizuar.

- Përfaqësimi gjinor;
- Përfaqësimi etnik;
- Përfshirja e personave të rinj;
- Përfaqësimi i popullsisë rurale.

Personat me aftësi të kufizuara janë grupi tjetër i synuar për t'u analizuar, megjithatë korniza ligjore nuk kërkon grumbullimin e të dhënave mbi bazën e aftësisë të kufizuar, e rrjedhimisht nuk ishte e mundur që të përfshijmë këtë grupë të rrezikuar në këtë analizë.

Metodologjia dhe Kufizimet

Analiza ka përdorur të dhënat nga listat e kandidatëve të botuara në ueb faqen e Komisionit Shtetëror Zgjedhor⁷ dhe meta të dhënat (metadata) të gjeneruara nga aplikacioni i listës të kandidatëve⁸, që është gjithashtu në dispozicion në faqen e internetit të KSHZ.

Aplikacioni ofron dy informacione që mund të gjenden lehtë mbi dy (2) tregues themelor të kërkimit: Partitë politike dhe njësitë zgjedhore. Kombinimi i këtyre treguesve grumbullon të dhënat për parametrat e përfaqësimit gjinor, grupit të moshës, dhe vendbanimit⁹ të kandidatëve.

⁷ <https://drive.google.com/file/d/1n61MT7PT5JmZpUqr2E9BoYNQNOWQzsbw/view>

⁸ <https://candidatelist.sec.mk/DashBoard>.

⁹ Vendbanimi i kandidatëve është treugar në aplikacion për shkak kërkesave të KSHZ dhe procedurave administrative që kërkojnë informacion për kandidatët nga gjykatat themelore. Vendqëndrimi është

Për disa tregues tjerë, që nuk janë përfshirë në aplikacionin e listave zgjedhore, janë ekzaminuar burimet e të dhënave shtesë dhe janë konsultuar këto institucione: Enti shtetëror për statistika, Byroja për zhvillim rajonal, Agjencia për Rini dhe Sport dhe të ngjajshme.




Figura 2: Funkcionalitetet e aplikacionit të listës të kandidatëve

Për shkak të shpërthimit të COVID-19 dhe ndaljes të aktiviteteve zgjedhore, nuk është e qartë nëse këto lista për kandidatë do të jenë përfundimtare apo ata do të ndryshohen kur do të vazhdojnë aktivitetet zgjedhore. Sipas Kodit Zgjedhor, lista e kandidatëve mund të ndryshohet mbi dy baza (Neni 67):

- Nëse kandidati nuk i përmbush kushtet e vendosura nga KZ, në atë rast kandidati do të zëvendësohet brenda 48 orëve;
- Në rast se kandidati vdes. KZ ofron dy mundësi, kur kandidati vdes në ditën e vërtetimit të listës dhe në periudhën prej më pak se 10 ditëve nga dita e votimit.

Duke e patur parasysh këtë që është përmendur më sipër, nuk është e qartë se cila do të jetë procedura nëse ndonjë nga kandidatët nuk i përmbush më kushtet nga KZ (baza 1), apo ka vdekur. Gjasat që të ndodhë ndonjë prej opsioneve është e lartë sepse dy muaj kanë kaluar nga koha kur listat e kandidatëve janë parashtruar dhe vërtetuar.

Në rast se kanë ndryshuar listat e kandidatëve, gjetjet nga analiza nuk do të jenë plotësisht relevante.

përdorur kur është analizuar përfaqësimi rural/urban.

Pasqyra e përgjithshme e listave të kandidatëve për Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2020

Sipas informacionit të KShZ, 15 parti politike dhe koalicione kanë parashtruar listat për kandidatë për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të caktuara për 12 prill, 2020. Nga këtë, dy (2) janë koalicione dhe trembëdhjetë (13) janë parti politike të regjistruara. Meqenëse pragu i kërkuar për organizimin e procesit zgjedhor jashtë shtetit nuk është arritur, analiza shqyrton vetëm listat për kandidatë të parashtruara për gjashtë (6) njësitë zgjedhore brenda shtetit dhe jo për atë një që është jashtë shtetit.

Si të tilla, janë regjistruar 1560 kandidatë në 78 lista të parashtruara nga 15 parti politike dhe koalicione për njësitë zgjedhore brenda shtetit. Numri i listave të parashtruara për çdo njësi zgjedhore është ofruar në tabelën më poshtë.

Tabela 1: Shpërndarja e listave për kandidat dhe votuesve për njësi zgjedhore

Njësia zgjedhore	1	2	3	4	5	6
Lista për kandidat	13	15	13	13	14	10
Numri i votuesve (zgjedhjet e vitit 2020¹⁰)	310.238	321.360	280.249	284.119	315.511	310.504

Korniza ligjore specifikon se devijimi maksimal i numrit të votuesve ndërmjet njësive zgjedhore nuk mund të jetë më i madh se -5% deri në +5% të numrit mesatar të votuesve për njësinë zgjedhore¹¹. Sa i përket numrit të listave të parashtruara për këto zgjedhje, mund të vëzhgohet se njësia zgjedhore 6 ka numrin më të ulët të listave për kandidat. Kjo mund të shpjegohet me faktin se kjo njësi zgjedhore ka përqindjen më të lartë të popullsisë me përkatësi etnike shqiptare. Me disa përjashtime në ciklet e mëparshme zgjedhore, shumica e votuesve votojnë për kandidatët/listat me përkatësi të njëjtë etnike.

Përderia partitë/koalicionet e mëdha politike kanë parashtruar listat për të gjithë njësitë zgjedhore në vend, po duket se partitë më të vogla politike që nuk targetojnë votuesit etnik shqiptar, nuk kanë parashtruar një listë zgjedhore për këtë njësi. Nga ana tjetër, një ofertë më e vogël politike nënkupton se votuesit e kësaj zone kanë më pak mundësi për të zgjedhur se votuesit nga njësitë tjera zgjedhore. Në rast se oferta ishte më e pasur/lartë atëherë ata do të votonin ndryshe.

Përfaqësimi gjinor

10 Të dhënat e KShZ

11 Kodi zgjedhor

Pjesëmarrja e barabartë nga gratë në politikë dhe qeveri është thelbësore për ndërtimin dhe ruajtjen e demokracisë. Nëse qeveritë demokratike u përgjigjen qytetarëve, ata duhet të jenë me të vërtetë përfaqësuese. Historikisht, në Republikën demokratike të Maqedonisë së Veriut, përpjekjet thelbësore për rritjen e pjesëmarrjes të grave në politikë dhe përfshirjen në proceset e marrjes të vendimeve filloi me prezantimin e veprimeve afirmative (kuotave) në legjislacionet e ndryshme. Në fillim është prezantuar kouta prej 30 përqind në vitin 2004. Ndryshimet e KZ në vitin 2015 kanë rezultuar me një rritje të kuotës në 40 përqind. Është me rëndësi të theksohet se Neni 153a i KZ i prezantuar në vitin 2014 garanton pozitën e një gruaje tjetër në listë nëse ajo që është zgjedhur tërhiqet nga pozita. Këto janë mekanizma efektiv për promovimin e pjesëmarrjes së grave në jetën politike dhe publike, në pajtim me përkushtimet e OSBE-së dhe standardet ndërkombëtare.

“Kuota është instrument matës pozitiv që synon të përshpejtojë arritjen e pjesëmarrjes të balancuar gjinore dhe përfaqësimin duke vendosur një proporcion të përcaktuar (përqindje) apo numër të vendeve apo ulëseve që duhet të plotësohen, apo ndahen për, gratë dhe/ose burrat, në përgjithësi nën rregullat apo kriterete caktuara.” Instituti European për Barazi Gjinore

Në përgjithësi, për parashtrimin e listave për zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2020, listat për kandidatë kanë 42,78% femra dhe 57,22% kandidatë meshkuj që është pak më shumë sesa kërkesa ligjore prej 40%. Në tabelën më poshtë janë prezantuar përqindjet (%) të femrave në kuadër të listave për kandidat për çdo njësi zgjedhore (NjZ) në shtet.

Siç mund të shihet, përqindjet janë pothuajse uniforme nëpër zonat zgjedhore, me përqindjen më të lartë në NjZ 4 (44,17) dhe më të ulët në NjZ 6 (41,50).

Tabela 2: Përfaqësimi gjinor në listat për kandidatë për njësi zgjedhore

Njësia zgjedhore	1	2	3	4	5	6
Të gjithë listat për kandidatë –	43,21	42,33	42,69	44,17	43,21	41,50
Përfaqësimi i femrave në %						

Në lidhje me kuotën gjinore në kuadër të listave për kandidatë të partive/koalicioneve politike, janë ofruar detaje për çdo parti/koalicion politik dhe për çdo njësi zgjedhore në Aneksin 1. Të gjithë listat e parashtruara nga partitë/koalicionet politike kanë respektuar kuotën gjinore, me përjashtim të listës për kandidatë nga BSD në NjZ 5 me vetëm 35% përfaqësim gjinor. Përfaqësimi më i lartë i grave në shtet dhe për NjZ është vërejtur në listat për kandidatë të parashtruara nga BDI me 47,78% (në përgjithësi) dhe 60% për NjZ 4.

Duke analizuar vendosjen e grave kandidate në listën zgjedhore, një kusht tjetër që rrjedh nga ligji, të gjithë partitë politike kanë respektuar rregullën e vendosur dhe, në këtë mënyrë, kanë mundësuar gratë kandidate për të qënë të vendosura në ulëse “fituese/konkurruese”.

42,8% e kandidatëve në lista janë përfaqësuar nga gratë përderisa vetëm

24,4% e listave kanë gratë si bartëse të listës

Një shikim më i afërt i listave zgjedhore nga perspektiva e grave që janë bartëse të listës tregon një situatë të ndryshme. Nuk ka një kërkesë ligjore për vendosjen e grave në pozitën e parë. Megjithatë, numri i grave që janë bartëse të listave tregon se sa e fuqishme është pozita e grave në hierarkinë e partisë politike. Siç tregon tabela më poshtë, përfaqësimi i grave kandidate si bartëse të listave është shumë i ulët në të gjithë spektrin politik, me NjZ 1 që ka përfaqësimin më të lartë. Detajet për çdo parti/koalicion politik dhe njësi zgjedhore janë dhënë në

Aneksin 2.

Tabela 3: Numri i grave si bartëse të listave për kandidatë për njësi zgjedhore

Njësia zgjedhore	1	2	3	4	5	6	Të gjitha
Gjithsej # i listave për kandidatë	13	15	13	13	14	10	78
# i listave për kandidatë në të cilat grate janë bartëse të listës	6	3	3	1	3	3	19 (24,35%)

Në lidhje me partitë/koalicione politike, numri më i lartë i listave për kandidatë që kanë bartëse gratë është propozuar nga “Zë për Maqedoninë - Глас за Македонија“, katër (4) nga gjashtë (6). Të gjithë partitë dhe koalicionet tjera ose nuk kanë gratë si bartëse të listave, apo kanë në një apo dy lista për kandidatë. Është me rëndësi të theksohet se BDI si partia me përqindjen më të lartë të përfaqësimit gjinor në lista, nuk ka listë të kandidatëve ku bartësja është grua.

Përfaqësimi Etnik

Maqedonia e Veriut është një shoqëri shumë etnike dhe shumë konfesionale. Duke ndjekur ndryshimin politik në fillim të viteve 1990, shteti është përpjekur për të dizajnuar një strukturë të organizatës shtetërore që është e aftë të pranojë dallimet përmes mekanizmave dhe instrumenteve të ndryshme. Periudha

Vetëm 3 parti politike ofrojnë një përbërje shumë-etnike të listave për kandidatë (duke përfshirë kandidatët shqiptarë

tranzitore ka rezultuar me formimin e partive politike që ishin të ndara në vija etnike. Me disa përjashtime, deri në zgjedhjet parlamentare të vitit 2016, partitë politike me anëtarësim dominant të etnisë maqedonase më së shumti kanë propozuar kandidatë me përkatësi etnike maqedonase dhe te partitë politike me anëtarësim dominant të përkatësisë etnike shqiptare kanë propozuar kandidatë me përkatësi etnike shqiptare. Partitë politike të bashkësive tjera etnike siç janë romët, sërbët, turqit dhe boshnjakët do të ishin pjesë e koalicioneve parazgjedhore

Në vitin 2016, për herë të parë Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM) ka përfshirë kandidatë me përkatësi etnike shqiptare në listat e tyre për kandidat.

Për zgjedhjet parlamentare të vitit 2020, për herë të parë, një parti politike Lëvizja Besa ka hyrë në një koalicion parazgjedhor me një koalicion të udhëhequr nga LSDM. Deri tani janë formuar vetëm koalicione paszgjedhore ndërmjet partive politike etnike maqedonase dhe etnike shqiptare.

Meqënëse ka dallime në emrat dhe mbiemrat e komuniteteve etnike, për qëllimet e kësaj analize, dallimi i bashkësisë etnike të kandidatit është bërë duke analizuar emrin dhe mbiemrin e tij/saj. Në këtë mënyrë, meqënëse nuk ka të dhëna të bazuara në dëshmi (deklarata e përkatësisë etnike) por në fakt një tregues të përafërt të përbërjes etnike të listave për kandidatë. *Rrjedhimisht, gjetjet më poshtë bazohen në interpretimin subjektiv të autorit dhe ata prezantohen vetëm për qëllimin e të paturit të një kuptimi të përgjithshëm për këtë parametër të listës për kandidatë.* Përbërja e detajuar e listës për partitë politike për NjZ është prezantuar në Aneksin 3. Gjetjet e përmbledhura janë prezantuar në tabelën më poshtë.

Tabela 4: Numri i listave shumë-etnike për kandidatë në njësitë zgjedhore

Njësitë zgjedhore	1	2	3	4	5	6	Të gjithë
Listat e përgjithshme # të kandidatëve	13	15	13	13	14	10	78
# i listave për kandidat përfaqësim shumë-etnik	4	8	4	5	9	5	35

Të gjithë njësitë zgjedhore kanë lista për kandidatë me përfaqësim shumë-etnik dhe numri i listave të tilla pasqyron përbërjen etnike të popullsisë në njësitë zgjedhore. Për shembull, NjZ 2 NjZ 5 dhe NjZ 6 si njësitë me popullsi të përziera etnike kanë numër më të lartë të listave të përziera etnike krahasuar me NjZ 1, NjZ 3 dhe NjZ4 ku grupet etnike që jetojnë atje janë homogjene.

Siç është përmendur më sipër, ka dy koalicione të madhe që marrin pjesë në zgjedhjet e vitit 2020. Që të dyja përfshijnë, krahas komunitetit etnik maqedonas, partitë politike që përfaqësojnë romët, turqit, sërbët, dhe komunitetin boshnjak. Listat për kandidatë të koalicioneve kanë një përfaqësim etnike të përziera, megjithatë mund të supozohet se diversiteti në këto lista rezulton nga marrëveshja e koalicionit ndërmjet partive politike dhe mund të mos jetë tregues i përfshirjes etnike në kuadër të partisë.

7 parti politike kanë përbërje shumë etnike të listave, por nuk kanë kandidatë me përkatësi etnike shqiptare.

3 parti politike kanë lista shumë etnike për kandidatë, por nuk kanë kandidatë me përkatësi etnike maqedonase.

Në anën tjetër, një shqyrtim i përbërjes etnike i listave për kandidatë të partive politike të vetme, tregon një tendencë të përbërjes të përzier etnike të listave. Lista të tilla për kandidatë mund të interpretohen si një pasqyrë e anëtarësisë shumë etnike të partisë, e kështu edhe përfshirja e përkatësive të ndryshme etnike brenda një partie politike dhe platforma zgjedhore të bazuar në nevojat e qyterave në vend se në përkatësinë etnike.

Këto janë parti të sapo themeluara apo të vogla, siç janë BSD, Partia Politike Demokratike, Bashkimi Demokratik Qytetar. Sa për ilustrim, në tabelën më poshtë është prezantuar numri i kandidatëve me përkatësi të ndryshme etnike në listat për kandidatë të partive të lartë përmendura. Përderisa shumica (deri në 20 kandidatë për listë) është me prejardhje etnike maqedonase,

numri i kandidatëve të prezantuar në tabelën më poshtë është me përkatësi etnike shqiptare, boshnjake, rome dhe maqedonas muslimanë.

Tabela 5: Numri i kandidatëve me përkatësi të ndryshme etnike për njësinë zgjedhore

Njësia zgjedhore	1	2	3	4	5	6	Të gjithë	Gjithsej Kandidatë	% Përkatësia etnike
BDQ	0	2	0	3	4	-	9	100	9
Demokratët	0	7	3	2	3	6	21	120	17.50
BSD Shkup	2	1	2	0	2	-	7	100	7.00

Edhe pse në aspekt të përqindjes, është i ulët, si një tendencë mund të jetë një zhvillim premtues. Nëse vazhdon mund të kontribuojë për kohezionin shoqëror në vend dhe të neutralizojë hendekun e gjërë të ndarjes etnike dhe përçarjes¹².

Në lidhje me të ashtëquajturin “Blloku shqiptar”¹³ të partive politike që përfaqësojnë interesat e komunitetit shqiptar, lista përveç shumicës të kandidatëve me përkatësi etnike shqiptare përfshin edhe përfaqësues të komunitetit të maqedonasve musliman, romëve dhe turqve.

Në veçanti listat për kandidatë të BDI-së (14.15% komunitete tjera etnike). Nuk ka kandidat me prejardhje etnike maqedonase në listën për kandidatë në këto tre parti politike, as që ka kandidatë me prejardhje etnike shqiptare në listat tjera për kandidatë të “Bllokut maqedonas” të partive politike, përveç atyre tre më sipër. Kjo përfshin gjithashtu edhe listën e koalicionit të udhëhequr nga OBRM - PDUKM.

¹² “Jetët paralele”, Lijbers, Univerziteti i Utrehtit, 2015

¹³ BDI, PDHS, Alternativa-ASH

Përfaqësimi i personave të rinj (18-29 vjet)

Sipas vlerësimeve të Entit shtetëror për statistika në vitin 2018¹⁴, shteti kishte një popullsi prej 2.077.132 banorsh dhe në vitin 2020 mosha mesatare¹⁵ është 39,116 vjet. Kjo tregon se popullsia po plaket¹⁷ që përfaqëson një sfidë për përfshirjen dhe pjesëmarrjen e personave të rinj në jetën publike. Sipas Strategjisë Nacionale për të Rinj 2016 – 2025¹⁸, nocioni ‘persona të rinj’ (rini) i referohet çdo personi(ave) ndërmjet moshës 15 dhe 29 vjet. Kjo është një kategori që mban një potencial të madh si një burim kryesor për përparimin shoqëror, por gjithashtu një kategori që është shumë e rrezikuar nga ndryshimet sociale dhe ekonomike në shoqëri.

Përveç përpjekjeve vijuese për të trajtuar çështjet që janë shqetësuese për personat e rinj, hulumtimet e ndryshme kanë treguar se 97% prej tyre nuk janë të kënaqur¹⁹ me pozitën e tyre në shoqëri dhe 32% e shohin punësimin e tyre në të ardhmen²⁰ jashtë shtetit.

Përfshirja e personave të rinj në listat për kandidatë gjatë zgjedhjeve mund të shihet si mundësi për liderët e rinj politik që të ndikojnë në zhvillimin e politikave, marrjen e vendimeve dhe proceset e zbatimit. Nëse zgjedhen si deputetë, të rinjtë mund të avokojnë më mirë për të inforparuar dhe trajtuar çështjet e të rinjve në mënyrë domethënëse.

Tabela 6: Numri i kandidatëve të rinj dhe përqindja e femrave në kuadër të listave për kandidatë

Njësitë zgjedhore	1	2	3	4	5	6	All	%
Numri i kandidatëve	280	300	260	240	280	200	1560	100
Numri i kandidatëve të rinj (18-29 vjet)	48	49	60	43	59	43	302	19,36
Numri i grave të reja kandidate	25	27	18	21	28	19	138	8,85
% e femrave brenda grupmoshës 18-29	53%	55%	30%	49%	48%	44%		

14 Regjistrimi i fundit i popullsisë është kryer në vitin 2002 <http://www.stat.gov.mk/>

15 Mosha mesatare është mosha që ndanë popullsinë në dy grupe të barabarta numerike; domethënë, gjysma a njerëzve janë më të rinj se kjo moshë dhe gjysma më të vjetër. Është një indeks i vetëm që përmbledh shpërndarjen e moshës të popullsisë.

16 <https://www.statista.com/statistics/510328/average-age-of-the-population-in-macedonia/>

17 Në vitin 2000 mosha mesatare ishte 32,3 vjet

18 <http://strategijazamladi.mk/sites/default/files/National-Youth-Strategy-2016-2025.pdf>

19 Pjesëmarrja socio-politike e të rinjve në Maqedoninë e Veriut. Apatia, Optimizmi apo dëshprimi <https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2019/12/WFD-Youth-NMK.pdf>

20 Hulumtim i brendshëm i IFES, 2020

Tabela më lartë tregon se NjZ 3 dhe NjZ 6 kanë numrin më të lartë të kandidatëve të rinj, ndërsa përfaqësimi i grave ndërmjet kandidatëve të rinj është më shumë se 40% në të gjithë njësitë zgjedhore, përveç në NjZ 4. Nuk është e qartë se pse kjo NjZ e veçantë ka një përqindje më të ulët të kandidatëve të rinj, megjithatë përfaqësimi i grave brenda kësaj grupmoshe është inkurajues, që tregon se partitë politike sigurojnë mundësitë për gratë e reja që të marrin pjesë në garën zgjedhore si dhe mundësi për gratë e reja për t'u zhvilluar më tutje dhe avancuar brenda partive politike.

Përfshirja e kandidatëve të rinj në listat e partive dhe për çdo njësi zgjedhore është treguar hollësisht në Aneksin 4. Përveç kësaj, Partia Popullore e Romëve ka përfaqësim prej 45% të kandidatëve të rinj brenda listave të tyre për kandidat, e ndjekur nga Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa me 32,50% dhe Partia Demokratike e Shqiptarëve me 29%. Kjo nuk është e pazakontë sepse edhe komuniteti etnik rom dhe shqiptarë ka shkallë më të lartë të natalitetit dhe moshë më të ulët mesatare krahasuar me komunitetin etnik maqedonas.

Kur analizohet vendosja e kësaj grupmoshe në pesë (5) pozitat më të larta në listat për kandidat, numrat variojnë ndërmjet NjZ, me më të ultën në NjZ 6 dhe me të lartën nj Nj 2.

Nga gjithsej 1560 kandidatë 19% janë persona të rinj të moshës 18-29 vjet.

Prej tyre, 138 janë gra.

Tabela 7: Kandidatët e rinj në 5 pozitat më larta në listat për kandidatë

Njësia zgjedhore	1	2	3	4	5	6	Të gjitha
Numri i përgjithshëm i personave të rinj (18-29 vjet) në listat për kandidatë	48	49	60	43	60	43	302
Kandidatët e rinj në 5 pozitat më të larta të listës	5	8	6	6	7	2	34

34 kandidatë të rinj kanë pozitë të mira në lista t'u zgjedhur deputetë

Duke patur parasysh se nga 120 deputetë të parlamentit gjatë viteve 2016-2020, vetëm dy (2) kanë patur më pak se 30 vjet²¹, dhe tani 34 persona të rinj janë në lista në pozita me mundësi për të fituar, perspektivat e rritjes të këtij numri janë të larta. Në afat të gjatë, kjo mund të sjellë deri te një përfshirje më e mirë sociale dhe politike të personave të rinj në shoqërinë udhëheqëse.

Përfaqësimi Rural – Kandidatët nga Komunat rurale

21 https://eacea.ec.europa.eu/national-policies/sites/youthwiki/files/gdlformer_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf

Organizimi territorial i shtetit është në 80 komuna nga të cilat 38 janë rurale. Reth 44% e popullsisë²² jeton në zonat rurale, të cilat kanë cilësi më të ulët të jetës krahasuar me popullsinë në zonat urbane për shkak të qasjes më të kufizuar apo më të varfër në shërbime, mungësë të mundësive për punësim dhe braktisjes të zonave rurale²³.

Kjo është arsyeja se pse ka nevojë që përmes politikave të zhvillimit rural të rritet investimi në infrastrukture dhe investimet në rivitalizimin e fshatrave me qëllim që ata të bëhen vende tërheqëse për personat e rinj dhe sipërmarrësit për të jetuar dhe punuar atje.

Një tregues i qëllimit të partive politike për të trajtuar nevojat dhe prioritetet e komunitetit lokal dhe për të siguruar një përfshirje të duhur politike të popullsisë rurale, mund të shihet gjithashtu kur analizohet përfaqësimi i kandidatëve nga komunitetet rurale në listat për kandidat gjatë zgjedhjeve apo ndërmjet lidhësive të partive politike.

Tabela 8: Numri i kandidatëve që jetojnë në komunat urbane dhe rurale

Gjithsej komuna	Komuna urbane	Komuna rurale
80	42 (ose 52.5%)	38 (ose 47.5%)
Gjithsej kandidatë	Kandidatë nga komuna urbane	Kandidatë nga komuna rurale
1560	1303 (ose 83.5%)	257 (ose 16.5%)

Siç tregon edhe tabela më lartë, numri i kandidatëve që jetojnë në komunat rurale është 5 herë më i vogël sesa kandidatët që jetojnë në komunat urbane. Ky disproporcion mund të interpretohet si mungesë e interesit dhe përkushtimit të partive politike për të trajtuar çështjet e shqetësimit për popullsinë rurale. Kjo gjithashtu mund sjellë deri te zvogëlimi i mëtutjeshëm i interesit dhe investimet që kontribuojnë për një zhvillim të barabartë rajonal që mund të sjellë deri te zgjerimi ndërmjet fushave urbane dhe rurale.

5 herë më i vogël i kandidatëve që jetojnë në zona rurale krahasuar me komunat urbane

22 Të dhënat e regjistrimit të vitit 2002 kanë prezantuar Strategjinë Nacionale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2014-2020 <http://extwprlegs1.fao.org/docs/pdf/mac176055.pdf>

23 Strategjia për zhvillim dhe rrjetin rural <http://ruralnet.mk/wp-content/uploads/2019/04/%D0%A1%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D1%98%D0%B0-%D0%9C%D0%A0%D0%A0-2019-2022-final.pdf>

Gjetjet dhe Përfundimet

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2020 mund të konsiderohen të ndryshme nga praktika e mëparshme në organizimin e zgjedhjeve në shumë aspekte. Në historinë e shtetit të pavarur, kjo është hera e parë që procesi i zgjedhjeve të fillojë dhe të jetë duke pritur me qëllim që të vazhdojë më vonë.

Në të vërtetë, shteti është përballuar me sfidën e shpërthimit të COVID-19 dhe duhej të prezantojë masat për luftimin e shpërthimit. Kjo është situatë e re për të cilën nuk kishte udhëzime, praktikë dhe procedura operative ekzistuese më parë.

Korniza ligjore duhet të ndryshohet dhe të plotësohet për kërkesat që dalin pandemia, masat e sigurisë dhe distancimi. Ky është një prioritet më i madh duke marrë parasysh zgjedhjet e ardhshme parlamentare.

Komisioni Shtetëror Zgjedhor, duke ndjekur kornizën ligjore që (do të) rishikohet, dhe masat dhe direktivat e sigurisë, nevojitet që të ndryshojë dhe të prezantojë procese dhe procedura të reja për administratën zgjedhore.

Procesi i vërtetimit të listës zgjedhore dhe afatet e fundit të ndërlidhur, janë testuar për herë të parë për këto zgjedhje. Duke u bazuar në zbatimin dhe sfidat që rrjedhin nga kjo, afate dhe procedura të caktuara mund të rishikohen gjatë procesit të reformës zgjedhore dhe rishikimin e kornizave ligjore.

Listat për kandidatë janë përfshirëse në bazë të grupeve të rrezikuara, çdo parti në shkallë të ndryshme.

Listat e kandidatëve janë me përfshirje gjinore në pajtim me kërkesat prej 40% nga Kodi Zgjedhor dhe në pajtim me kërkesat për vendosjen e grave kandidate në listën zgjedhore. Një e katërta (reth 25%) të listave për kandidatë kanë gra në në pozitat e para – udhëheqëse të listës.

Ka një tendencë në rritje të listave shumë etnike për kandidatë, kryesisht nga partitë e reja dhe të vogla, që përfshin dy komunitetet më të mëdha në vend.

Partitë politike të mëdha dhe tradicionale vazhdojnë me praktikën e përfshirjes të komuniteteve të vogla etnike dhe përjashtimin e atyre të mëdha; (Listat për kandidatë që përfaqësojnë komunitetin etnik maqedonas kanë tendencë për të përjashtuar përfaqësuesit e komunitetit etnik shqiptar dhe anasjelltas. Përjashtimi i vetëm është koalicioni i udhëhequr nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (shumica maqedonas) mbi dy baza: duke vendosur para kandidatët me përkatësi etnike shqiptare, dhe duke përfshirë në koalicion një parti politike me shumicën e bashkësisë etnike shqiptare.

Përfaqësimi i personave të rinj të moshës 18-29 është 19% në të gjithë listat e partive politike dhe vetëm 34 prej tyre janë vendosur në 5 pozitat më të larta të listës. Jo të gjithë prej këtyre pozitave janë fituese sidomos kur flasim për partitë e vogla politike.

Listat për kandidatë duket se janë “të orientura kah vendbanimet urbane” dhe kandidatët e propozuar që jetojnë në zonat rurale janë më pak të përfaqësuar në mënyrë disproporcionale për pesë here në krahasim me ata që vijnë nga zonat urbane.

Aneksi 1- Përfaqësimi gjinor

Partia politike	Njësitë zgjedhore						All %
	1	2	3	4	5	6	
BDQ	40	45	45	40	50	-	44
Bashkimi Demokratik për Integrim	50	50	40	60	50	45	48,78
Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa	40	40	40	45	45	40	41,67
OBRM – PDUKM dhe Koalicioni "Ripërtirja e Maqedonisë"	40	40	45	40	40	45	41,46
PDSH	40	40	40	-	40	40	40
INTEGRA	40	40	40	40	40	40	39,02
Koalicioni NE MUNDEMI	50	45	50	50	50	55	47,97
E Majta	45	40	40	40	40	40	40,83
ORRM – Partia e punëtorëve	40	40	50	40	50	40	43,33
Partia Popullore e Romëve	-	40	-	-	-	-	40
Asnëherë e Veriut – Vetëm Maqedoni	40	40	40	40	40	40	40,65
Zë për Maqedoninë	45	55	45	45	45	-	47
Demokratët	55	40	40	40	40	40	42
BSD Shkup	40	40	40	50	35	-	41
Partia Juaj	40	40	-	-	40	-	40

Burimi: Aplikacioni i listave për kandidat dhe llogaritjet e autorit.

Shënim: Shenja “–” tregon se partia politike nuk ka parashtruar listë për kandidatë për atë njësi zgjedhore

Aneksi 2- Gratë si bartëse të listave për kandidatë për parti të politike dhe njësitë zgjedhore

Partia Politike	Njësitë Zgjedhore						
	1	2	3	4	5	6	All
BDQ	1	0	0	0	0	-	1
Bashkimi Demokratik për Integrim	0	0	0	0	0	0	0
Aleanca për Shqipëtarët dhe Alternativa	0	0	0	1	0	0	1
OBRM – PDUKM dhe Koalicioni "Ripërtirja e Maqedonisë"	1	0	0	0	0	1	2
PDHS	0	0	0	-	0	0	0
INTEGRA	0	0	1	0	0	1	2
Koalicioni NE MUNDEMI	0	0	0	0	1	0	1
E Majta	0	0	0	0	1	1	2
ORRM – Partia e punëtorëve	0	0	1	0	0	0	1
Partia Popullore e Romëve	-	0	-	-	-	-	0
Asnjëherë e Veriut – Vetëm Maqedoni	1	0	0	0	0	0	1
Zë për Maqedoninë	1	1	1	0	1	-	4
Demokratët	1	1	0	0	0	0	2
BSD Shkup	0	1	0	0	0	-	1
Partia Juaj	1	0	-	-	0	-	1
Gjithsej për PP	6	3	3	1	3	3	

Burimi: Listat për kandidatë në faqen e internetit të KSHZ dhe llogaritja e autorit

Shënim:

1. Shenja “-“ përdoret për të treguar se partia politike nuk ka parashtruar listë për kandidatë për atë njësi zgjedhore
2. Shenja “0” tregon se partia politike nuk ka vendosur kandidatë grua si bartëse të listës për kandidat

Aneksi 3-Përfaqësimi etnik

Partia politike	Njësia Zgjedhore							Të gjithë	Gjithsej Kan.	% Bashkësisë Etnike
	1	2	3	4	5	6				
BDQ	0	2	0	3	4	-	9	100	9	
Bashkimi Demokratik për Integrim	0	0	6	5	6	0	17	120	14.17	
Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa	0	0	0	0	1	0	1	120	0.83	
OBRM – PDUKM dhe Koalicioni "Ripërtirja e Maqedonisë"	1	1	0	1	3	1	7	120	5.83	
PDSH	0	0	0	-	4	0	4	100	4.00	
INTEGRA	0	0	0	0	0	0	0	120	0.00	
Koalicioni NE MUNDEMI	3	7	3	1	6	12	32	120	26.67	
E Majta	0	1	0	0	0	2	3	120	2.50	
ORRM – Partia e punëtorëve	0	3	0	0	0	3	6	120	5.00	
Partia Popullore e Romëve	-	0	-	-	-	-	0	20	0.00	
Asnjëherë e Veriut – Vetëm Maqedoni	0	0	0	0	0	0	0	120	0.00	
Zë për Maqedoninë	2	0	0	0	1	-	3	100	3.00	
Demokratët	0	7	3	2	3	6	21	120	17.50	
BSD Shkup	2	1	2	0	2	-	7	100	7.00	
Partia e Juaj	0	1	-	-	0	-	1	60	1.67	
Gjithsej për PP	8	23	14	12	30	24				
Listat shumë etnike	4	8	4	5	9	5				
Gjithsej lista për NjZ	13	15	13	13	14	10				

Burimi: Listat për kandidatë në faqen e internetit të KSHZ dhe interpretimi i autorit

Shënim:

1. Shenja “–” është për të treguar se partia politike nuk ka parashtruar listë për kandidatë për njësinë zgjedhore
2. Shenja “0” tregon se partia politike nuk ka emëruar kandidatë me përkatësi të ndryshme etnike në listën për kandidatë për atë njësi zgjedhore

Aneksi 4- Përfaqësimi i Kandidatëve të rinj (18-29)

Partia politike	Njësia zgjedhore							Të gjithë (18-29)	Gjithsej Kan.	% Të Rinj
	1	2	3	4	5	6				
BDQ	0	3	5	5	9	-	22	100	22	
Bashkimi Demokratik për Integrim	9	2	6	8	6	3	34	120	28.33	
Aleanca për Shqiptarët dhe Alternativa	6	4	9	8	7	5	39	120	32.50	
OBRM – PDUKM dhe Koalicioni "Ripërtirja e Maqedonisë"	4	4	0	4	2	5	19	120	15.83	
PDSH	7	6	6	-	6	4	30	100	30.00	
INTEGRA	1	0	4	0	1	3	9	120	7.50	
Koalicioni NE MUNDEMI	3	2	3	3	3	5	19	120	15.83	
E Majta	4	3	9	2	8	5	31	120	25.83	
ORRM – Partia e punëtorëve	3	4	2	0	1	4	14	120	11.67	
Partia Popullore e Romëve	-	9	-	-	-	-	9	20	45.00	
Asnjëherë e Veriut – Vetëm Maqedoni	4	3	2	2	3	5	19	120	15.83	
Zë për Maqedoninë	2	4	4	3	5	-	18	100	18.00	
Demokratët	1	2	5	3	2	4	17	120	14.17	
BSD Shkup	4	3	5	5	6	-	23	100	23.00	
Partia e Juaj	0	0	-	-	0	-	0	60	0.00	
Gjithsej për PP	48	49	60	43	59	43				

Burimi: Aplikacioni i listave për deputet dhe llogaritjet e autorit

Shënim:

1. Shenja “-“ është përdorur për të treguar se partia politike nuk ka parashtruar listën për kandidat për atë njësi zgjedhore
2. Shenja “0” tregon se partia politike nuk ka emëruar kandidatë brenda grupmoshës 18-29 vjet në listën për kandidat për atë njësi zgjedhore